VENDIM
Nr. 203, datë 4.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-së

Në mbështetje të nenit 16, pika 11, nenit 22, nenit 23, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 127/2 prot., datë 2.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së,

konstatoi se:

- ERE ka hartuar draft-licencën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.
- Draft-licenca, me kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, saktëson spektrin e të drejtave dhe detyrimeve për çdo subjekt që licencohet në ushtrimin e këtij aktiviteti.
- Draft licenca saktëson tërësinë e të drejtave të ERE-s në raport me të licencuarin, në mbështetje të ligjit nr. 102/2010, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe legjislacionit të miratuar në zbatim të tij.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së.
2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti